



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT



Nr.Prot 610

Tiranë më, 11.07.2013

MIRATOHET

KRYETARI

BÛJAR LESKAJ



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT 2013-2017

Korrik 2013

PERMBAJTJA

<i>Hyrje:</i>	4
<i>Misioni:</i>	5
<i>Vizioni:</i>	5
<i>Vlerat dhe parimet tona:</i>	6
<i>Mandati:</i>	7
<i>Partnerët tanëstrategjik:</i>	8
<i>Taksapaguesit:</i>	8
<i>Kuvendi i Shqiperisë:</i>	8
<i>Qeveria:</i>	9
<i>Auditimi i brendshëm:</i>	10
<i>Mediat dhe shoqeria civile:</i>	10
<i>Agjensitë e zbatimit të ligjit:</i>	11
<i>SAI-t homologe, Organizatat ndërkombëtare të Auditimit, Shoqatat profesionale ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilist:</i>	11
<i>SIGMA:</i>	11
<i>DG-Budget:</i>	11
<i>Shoqatat profesionale kombëtare:</i>	12
<i>Mjedisi strategjik:</i>	12
<i>Rezultatet e Analizës së Pengesave:</i>	14
<i>Objektivat strategjike:</i>	15
<i>Objektivi Nr. 1. Zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH. Amendimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira evropiane:</i>	15

<i>Objektivi Nr. 2: Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit</i>	<i>16</i>
<i>Objektivi Nr. 3. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës.....</i>	<i>22</i>
<i>Objektivi Nr. 4. Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim:.....</i>	<i>24</i>
<i>Objektivi Nr. 5. Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit:.....</i>	<i>25</i>
<i>Objektivi Nr. 6 Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit:.....</i>	<i>27</i>
<i>Burimet:.....</i>	<i>29</i>
<i>Monitorimi i Strategjisë, kontrolli dhe raportimi:.....</i>	<i>31</i>

1. Hyrje:

Në vitin 2008, me asistencë të projektit të binjakëzimit të BE-së, Kontrolli i Lartë i Shtetit hartoi një strategji zhvillimi për vitet 2009-2012. Ajo mbështetej në katër drejtime kryesore: zhvillimi i kuadrit ligjor të institucionit, zhvillimi i metodologjisë së auditimit, i burimeve njerëzore dhe i mbështetjes administrative, duke përfshirë zhvillimin e teknologjisë së informacionit. Gjatë viteve 2009-2011 institucioni bëri përpjekje për zhvillimin e kapaciteteve të tij, por për shkak të angazhimit të pamjaftueshem të menaxhimit, mungesës së mbështetjes financiare dhe teknike si dhe qasjes disa herë të përgjithshme e pa një plan konkret veprimi të vetë dokumentit, Strategjia nuk u realizua në një masë të ndjeshme.

Ndryshimi në drejtimin e institucionit në dhjetor 2011 solli ndryshime të rëndësishme në filozofinë e menaxhimit të këtij institucioni. Kryetari i KLSH-së z.Bujar Leskaj¹ theksoi se zhvillimi perspektiv kërkon përmirësime të mëtejshme, duke e rikthyer vëmendjen në auditimin e performancës krahas konsolidimit të auditimit financiar, në përputhje me standardet INTOSAI, duke thëlluar luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij, në sinergji me organizatat e tjera të zbatimit të ligjit në vend, si dhe duke bashkëpunuar me institucionet supreme të auditimit (SAI) homologe në rajon dhe më gjerë.

Gjatë vitit 2012, KLSH ka zhvilluar aktivitete trajnimi intensiv të stafit, përkundrejt një pauze që kishte vitet e fundit. Ka aktivizuar burime të brendshme dhe ka siguruar mbështetjen e SAI-ve homologe, veçanërisht të SAI-t të Polonisë, Sllovenisë dhe Turqisë, si dhe një program të gjerë trajnimi për gjysmën e dytë të vitit 2012 nga SIGMA, duke siguruar edhe vazhdimësinë për vitin 2013. Institucioni në këtë periudhë ka dërguar auditues jashtë shtetit për trajnim një numër të barabartë me atë që kishte dërguar në shtatë vitet 2004-2011 të marra së bashku. Për vitin 2012, numri i ditëve të trajnimit në vit për punonjësit e KLSH është 19.4 ditë, tregues i barabartë me SAI-t evropiane. Institucioni ka aplikuar dhe siguruar mbështetje nga BE për një projekt binjakëzimi në shifrën 2.1 milion euro, në kuadër të programit IPA 2013, i cili do të fillojë në tremujorin e parë të vitit 2014.

Raporti i Progresit të Shqipërisë i Komisionit Evropian i Tetorit të vitit 2012 ka nënvizuar se: *“Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI”*². Synimi strategjik i KLSH për vitet 2013-2017 është modernizimi i institucionit për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI

¹ Nga fjala e zotit Bujar Leskaj, kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës për postin e Kryetarit të KLSH-se, me dekretin Nr.7163 date 17.11.2011(i miratuar nga Kuvendi i Shqiperise me 23.12.2011), mbajtur në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit me date 14.12.2011, me rastin e paraqitjes së platformës së tij për drejtimin e KLSH-së

² Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2012, faqe 66-67

2011-2017, si dhe kontributi për një qeverisje të mire, nëpërmjet luftës pa kompromis dhe në sistem të korrupsionit dhe parandalimit të tij.

2. Misioni:

Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikën me të mira të BE dhe me standartet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mire, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Dy partnerët tanë kryesorë janë taksapaguesit shqiptarë dhe Kuvendi i Shqipërisë. KLSH do të përqendrohet në informimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, se si janë angazhuar qeveria dhe entet publike për përdorimin e kontributit të taksapaguesve, sepse ky institucion i pavarur kushtetues është ndërtuar që të jetë një “agjent” i Kuvendit dhe një roje e parave publike. Nga ana tjetër, publiku e konsideron KLSH si një trupë profesionale të paanshme dhe objektive. Misioni i KLSH nuk është kufizuar vetëm në raportimin e përdorimit të parave publike në përputhje me ligjin, por duke qenë një trupë profesionale dhe me një gjykim prej eksperti, ai do të jap publikut të gjerë dhe Kuvendit opinionet e tij lidhur me mundësinë e përdorimit të këtyre parave në mënyrën më të mirë të mundshme, nëse ato janë përdorur me dobi, kursim e frytshmëri, apo e thënë ndryshe, sikurse njihet në terminologjinë profesionale, me Ekonomicitet, Efektivitet dhe Eficiencë.

Misioni i KLSH shtrihet edhe tek vlerësimi i përgjegjshmërisë qeveritare dhe të enteve të tjera publike në lidhje me përdorimin e burimeve publike në tërësi. Kjo do të thotë që KLSH do të vlerësojë edhe programet qeveritare dhe të enteve të tjera publike në lidhje me parashikueshmërinë, transparencën dhe *sa* e *si* rezultatet e këtyre programeve kanë kënaqur interesat e taksapaguesve shqiptarë. Nga ana tjetër, institucioni, në zbatim të këtij misioni angazhohet të vlerësojë edhe veprimtarinë e administratorëve publikë në lidhje me përmbushjen e përgjegjësive të tyre për përdorimin e parave publike. KLSH do të veprojë si një agjent ndryshimi, dhe jo si një spirancë që tërhiqet zvarrë.

3. Vizioni:

KLSH synon të jetë një trupë profesionale që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.

Paratë publike janë objekti kryesor i punës së KLSH-së. Qëllimi ynë është që me anë të auditimit të ndihmojmë institucionet publike për të përmirësuar veprimet operacionale që lidhen me

përdorimin e këtyre parave. Audituesit e KLSH nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të auditimit do të ndikojnë tek përdoruesit (administratorët publike) që të përdorin sa më me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet paratë publike, duke maksimizuar vlerën e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit i kushton vëmendje kryesore shtimit të vlerës së parave publike dhe për këtë qëllim do të përmirësojë strukturat organizative, cilësinë, teknikat dhe metodologjitë e auditimit. KLSH synon modernizimin e shpejtë të tij, drejt auditimeve profesionale bazuar tërësisht në standardet INTOSAI dhe IFAC, larg veprimtarisë së kontroll-revizionit të rëndomtë dhe në përputhje me rekomandimet e Progres Raportit të Bashkimit Evropian të vitit 2012 për Shqipërinë.

4. Vlerat dhe parimet tona:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të realizuar misionin, e mbështet veprimtarinë e tij mbi vlerat dhe principet e mëposhtme:

Pavarësia: Pavarësia është një element shumë i rëndësishëm për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Shqipërisë, për t'i ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme. Pavarësia e KLSH parakupton që i gjithë procesi i auditimit, që nga planifikimi, realizimi dhe raportimi t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta.

Objektiviteti: Të gjitha raportet e KLSH për gjetjet e auditimit do të jenë të paanshme dhe të pandikuara nga palët e treta. Ato do të kenë saktësinë dhe besueshmërinë e duhur në sajë të kompetencës profesionale, vlerave etike dhe morale që bartin dhe demonstrojnë audituesit e KLSH.

Integriteti: Kontrolli i Lartë i Shtetit do të angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etiko-profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit do të kryhet jashtë çdo konflikti interesi dhe zhvillimi profesional parashikohet të jetë një ndër fjalët kyçe të veprimtarisë së KLSH³.

Përgjegjshmëria: Në veprimtarinë e tyre, audituesit e KLSH veprojnë në interes të palëve kryesore të interesit (tatimpaguesit dhe Kuvendi), duke pasur parasysh edhe interesin e gjerë publik⁴. KLSH është e angazhuar për të ndihmuar Kuvendin ndaj llogaridhënies së qeverisë.

Profesionalizmi: KLSH udhëhiqet në veprimtarinë e tij audituese nga standardet profesionale të INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve të BE.

Bashkëpunimi: Në operationet e tij të auditimit, KLSH bashkëpunon intensivisht me subjektet e audituara, me strukturat e auditimit të brendshëm dhe auditues të tjerë të jashtëm, me nivelet e menaxhimit dhe me institucionet publike të pavarura, sidomos për të thelluar luftën kundër

³ Bujar Leskaj, Projekt-Ide .Paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë , Tiranë 14 Dhjetor 2011 faqe 13

⁴ "Parimet e auditimit të jashtëm", Brenda Porter, John Simo dhe David Hatherly, Edicioni i tretë, 2008

korupsionit dhe parandalimin e tij, si dhe me organizatat profesionale, akademike, shoqërinë civile dhe mediat.

Interesi publik : KLSH në procesin e auditimit angazhohet të japë rekomandime vetëm në interes të publikut. Këto rekomandime nuk do të ndikohen nga preferencat politike, etnike, fetare apo familjare, të stafit të KLSH.

Transparenca: Nënkupton dhe i referohet disponibilitetit të informacionit të raporteve të auditimit ndaj publikut të gjerë, në përputhje me rregullat që qeverisin këtë proces, me bindjen më të plotë të institucionit se transparenca i shërben publikut. Informacioni i përfutur nga auditimi do të jetë i hapur për publikun në formën e parashikuar nga ligji. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të angazhohet të promovojë transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

5. Mandati:

Mandati i Kontrollit të Lartë të Shtetit buron nga Kushtetuta e Shqipërisë (Neni 163) dhe nga Ligji i tij organik. Mandati është i orientuar nga interesat e publikut dhe të Kuvendit të Shqipërisë, për të marrë informacion mbi përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të enteve të tjera publike lidhur me përdorimin e burimeve publike. Ata duhet të sigurohen se paratë publike janë të sigurta, përdoren në mënyrën e duhur dhe shkojnë në destinacionin e parashikuar. Në funksion të këtyre interesave, KLSH kryen auditime financiare, të pajtueshmërisë, të performancës, si edhe ndërmer vlerësime të sistemit të auditimit dhe kontrollit të brendshëm tek strukturat qeveritare dhe entet e tjera publike.

Nga pikpamja e juridiksionit, mandati i Kontrollit të Lartë të Shtetit përfshin të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, lidhur me :

- ☞ Zbatimin e buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nga personat e tjerë juridikë, duke përfshirë llogaritë vjetore;
- ☞ Mbledhjen e të ardhurave publike;
- ☞ Përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e fondeve dhe pronës publike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
- ☞ Përdorimin e fondeve të ofruara nga Bashkimi Evropian ose organizata të tjera ndërkombëtare;
- ☞ Përdorimin, administrimin e fondeve dhe pronës publike dhe mbrojtjen e interesave ekonomike dhe financiare të Shtetit në personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e aksioneve, ose kur huatë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti;
- ☞ Partitë politike apo shoqatat për fondet që u janë akorduar nga Buxheti i Shtetit;
- ☞ Subjekte të tjera të përcaktuara në ligje të veçanta.

6. Partnerët tanë strategjikë

Kjo strategji dhe misioni i KLSH-së nuk mund të realizohen pa ndërtuar një partneritet funksionues me të gjithë aktorët e interesuar. Kjo është shpallur si prioritet strategjik i punës së institucionit. *“Duhet theksuar se KLSH-së nuk i cënohet pavarësia kur sinergjizon politikat dhe veprimet e tij me Departamentin e Antikorrupsionit pranë Kryeministrit, me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Brendshëm dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrit të Financave dhe, në veçanti me Prokurorinë e Shtetit, por përkundrazi i rritet efektiviteti dhe eficientia e tij, në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese”*⁵. Ne konsiderojmë si partnerët tanë strategjike kryesorë në realizimin e misionit tonë: Taksapaguesit (qytetarët shqiptarë), Kuvendin e Shqipërisë, Qeverinë, Auditimin e Brendshëm, Shoqërinë Civile, Mediat, SAI-t (Institucionet supreme të auditimit) homologe, anëtare të EUROSAI ose INTOSAI, Organizatat ndërkombëtare të auditimit, SIGMA (Programi “Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim” i Bashkimit Evropian dhe Organizatës OECD) dhe DG-Budget (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Bashkimit Evropian), Shoqatat profesionale të auditimit dhe kontabilistëve, si dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit.

KLSH është i ndërgjegjshëm se nuk mund t’i arrijë objektivat e përcaktuara në këtë Strategji pa ndihmën e qenësishme të partnerëve të tij kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Taksapaguesit: Partneriteti me taksapaguesit ose me të gjithë qytetarët shqiptarë buron nga interesat ekonomike. Qytetarët janë të interesuar që vlera e kontributeve të tyre të maksimizohet, çka ngjason me misionin e KLSH. Për realizimin e misionit të tij, KLSH zhvillon një strategji komunikimi, e cila ka për qëllim t’i drejtohet taksapaguesit nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe të sigurojë mundësinë dhe aksesin e plotë të qytetarëve për t’i kontribuar këtij qëllimi të përbashkët. Produktet e kësaj strategjie janë botime të ndryshme si libra, buletine, broshura informative apo faqja e internetit, konferenca dhe njoftime për shtyp, etj., të cilat janë në funksion të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve. Pritshmëritë dhe kërkesat e taksapaguesve për mirëqeverisje dhe luftë efektive ndaj korrupsionit kërkojnë një SAI modern, transparent dhe të përgjegjshëm.

Kuvendi i Shqipërisë: Vite më parë, me të drejtë është theksuar në raportet e SIGMA-s: *“KLSH do të jetë agjent i ndryshimit dhe jo spirancë që tërhiqet zvarrë”*. Kuvendi është partneri ynë kryesor. KLSH i raporton Kuvendit lidhur me përgjegjshmërinë qeveritare të përdorimit të burimeve publike. Në këtë kontekst, Kuvendi është i interesuar që KLSH të jetë një institucion i fuqishëm dhe profesional. Krahas shpërndarjes së burimeve publike në subjektet publike, ai ka deleguar edhe përgjegjësitë për përdorimin e tyre por ai mbetet i interesuar që të verifikojë se si janë përmbushur këto përgjegjësi. Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqitet si instrumenti kryesor për të verifikuar se si janë përmbushur përgjegjësitë e këtyre subjekteve në pikëpamje të funksioneve të deleguara me ligj. Partneriteti i KLSH me Kuvendin realizohet kryesisht nëpërmjet Komisionit të

⁵ Bujar Leskaj, Projekt-Ide .Paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë , Tiranë 14 Dhjetor 2011 faqe 10.

Ekonomisë dhe të Financave, i cili diskuton dhe i propozon Kuvendit çështje që kanë të bëjnë me buxhetin e shtetit dhe burimet publike në tërësi. Përveç informacionit të paraqitur nga KLSH në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, KLSH i paraqet Kuvendit edhe raporte për zbatimin e buxhetit të shtetit si dhe raportin vjetor për veprimtarinë e tij. Ndërkohë, KLSH vlerëson me vëmendje shqetësimet e ngritura në Kuvend në lidhje me përdorimin e parave publike dhe duke ruajtur pavarësinë e tij i bën ato objekt të auditimit. Partneriteti i KLSH me Kuvendin e Shqipërisë vlerësohet i domosdoshëm për të mbështetur veprimtarinë e KLSH me anë të rezolutave bazuar në raportet dhe rekomandimet e auditimit. Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e 22 dhjetorit 2011 “Për nxitjen e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit” i inkurajon Shtetet Anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre të “*aplikojnë parimet e vendosura në Deklaratën e Limës dhe në Deklaratën e Meksikos, si dhe të intensifikojnë bashkëpunimin me INTOSAI, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të SAI-t*”.

Qeveria: Është përgjegjësi kryesor për hartimin dhe ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit. “*SAI-t nuk janë qeveri që të propozojnë dhe të ekzekutojnë politika, por pasi ato janë propozuar dhe zbatuar dhe pasi janë shpenzuar para publike, ne jemi atje për të informuar se çfarë po ndodh. Auditimet tona janë jetike për funksionimin e shtetit, për efektivitetin e tij, për mirëqenien e qytetarëve të tij, si dhe për demokraci dhe transparencë. Ky është roli ynë.*”⁶ Në këtë kuadër, fokusi kryesor i punës tone takohet me funksionet e pushtetit qendror dhe lokal dhe veçanërisht të Ministrisë së Financave si institucioni përgjegjës në qeveri për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe për sigurimin e kuadrit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Bashkëpunimi me qeverinë, në veçanti me Auditimin e Brendshëm është sanksionuar në një marrëveshje të veçante⁷ ku janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e palëve në këtë partneritet, bazuar dhe në Standardin ISSAI 9150 të INTOSAI. Strategjia e KLSH reflekton kërkesat e kësaj marrëveshjeje edhe në periudhat e ardhshme dhe sinergjizon përpjekjet për luftën ndaj korrupsionit dhe për parandalimin e tij, në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara dhe pikërisht: “*Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë*

⁶ Citim I Z. Jacek Jezierski, Kryetar i Zyrës Kombëtare të Auditimit (NIK) të Polonisë për lexuesit e revistës shkencore "Auditimi Publik", nëntor 2012, çështja e dytë.

⁷ Marrëveshja e Bashkëpunimit midis KLSH dhe Ministrisë së Financave me date 08.05.2012, nënshkruar nga Kryetari i KLSH z.Bujar Leskaj dhe Ministri i Financave z.Ridvan Bode.

*e detyrimit, e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë*⁸“.

Sistemi i Auditimit të Brendshëm: Është pjesë e partneritetit me qeverinë, por për rëndësinë që ka është evidentuar më vete. Një funksionim i konsoliduar i Auditimit të Brendshëm do të lehtësojë shumë realizimin e misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. KLSH bashkëpunon me Auditimin e Brendshëm nëpërmjet këshillimeve të vazhdueshme, shkëmbimit të planeve të punës, zhvillimit të metodologjive, trajnimeve dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta e deri në përdorimin e punës së Auditimit të Brendshëm, kur ajo cilësohet se është kryer në përputhje me standardet profesionale. Si Auditimi i Brendshëm ashtu edhe KLSH janë të angazhuar të mbështesin rekomandimet respektive të dhëna prej tyre ndaj subjekteve dhe t'i asistojnë ato për zbatimin e tyre. Në Raportin e Misionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Bashkimit Evropian (DG-Budget) në tetor 2012 theksohet: “DG-Budget e sheh marrëveshjen e KLSH me Ministrinë e Financave si një sinjal shumë pozitiv, pasi të dyja organizatat janë të përfshira në promovimin e qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies, përfshirë praktikën për të kuptuar më mirë rolin e Kontrollit të Brendshëm, auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm. Përveç kësaj, bashkëpunimi më i mirë operacional mund të çojë në shmangien e mbivendosjes midis KLSH dhe veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe monitorimin më të mirë të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit”.

Shoqëria civile dhe mediat : Ky partneritet buron nga nevoja e ndërsjelle që kanë palët për informacion. KLSH merr nga shoqëria civile dhe mediat informacione të vlefshme, të cilat mund t'i bëjë subjekte të auditimit, ndërkohe që mediat, në respekt të detyrimit dhe profesionit për të informuar qytetarët, marrin nga KLSH informacione mbi rezultatet e auditimit. Ky proces i ndërsjelle i shërben edhe rritjes së besimit të publikut në institucionin e KLSH si dhe monitorimit të tij nga publiku, ashtu edhe rritjes së besimit të publikut ndaj qeverisjes. Partneriteti me shoqërinë civile dhe mediat ka filluar të institucionalizohet në vitin 2012 nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara nga Kryetari i KLSH me disa OJF ndër me aktivet në luftën kundër korrupsionit dhe për më shumë transparencë në qeverisje⁹. Ky bashkëpunim është konceptuar rishtaz si një partneritet ku OJF-te do të marrin pjesë aktivisht në procesin e auditimit të KLSH, nëpërmjet ekspertizës së tyre në analizën e riskut, planifikim dhe kryerjen e auditimeve. Ai do të jetë pjesë e zhvillimeve strategjike të institucionit për vitin 2013-2017, duke sjellë një rol të shtuar të shoqërisë civile në rritjen e transparencës së KLSH, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e punës së tij.

⁸ Strategjia Ndërsektorale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013, f. 11.

⁹ Marrëveshjet e Bashkëpunimit datë 23 prill 2012 mes KLSH dhe organizatës Transparency International në Shqipëri, lëvizjes “Alternativa Civile”, Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, Institutit të Studimeve Bashkëkohore, Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Lëvizjes Evropiane Shqipëri.

Agjencitë e zbatimit të ligjit. Kontrolli i Lartë i Shtetit është një nga institucionet publike që luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, ndërkohe agjenci të tjera kanë detyra me të drejtpërdrejta në këtë kontekst, të tillë si Prokuroria e Shtetit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Departamenti Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, Autoriteti i Konkurrencës, Agjencia e Prokurimeve Publike, etj. KLSH udhëhiqet nga ideja se një bashkëpunim me këto agjenci në fushën e shkëmbimit të informacionit, do ta rrisë shumë efektivitetin e luftës kundër korrupsionit, veçanërisht në luftën kundër mashtrimit financiar. Në këtë kuadër gjatë vitit 2012 ky bashkëpunim është sanksionuar me nënshkrimin e disa marrëveshjeve dhe në vijim pritet të nënshkruhen edhe marrëveshje të tjera.¹⁰

SAI-t homologe, Organizatat ndërkombëtare të Auditimit, Shoqatat profesionale ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilisteve. KLSH është anëtar i INTOSAI që nga viti 1984 dhe anëtarësimi në këtë organizate e obligon atë për të respektuar standardet e kësaj organizate, duke i zhvilluar ato në përputhje me kushtet e vendit tonë. Përveç kësaj një bashkëpunim i ndërsjelle parashikohet të zhvillohet edhe me EUROSAI-n , IFAC si dhe me institucione homologe të SAI-ve si Polonia, Sllovenia, Turqia, Kroacia, etj dhe veçanërisht me zyrën e Audituesit të Përgjithshëm në Kosove, me të cilat janë nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi për fusha me interes të ndërsjelle¹¹. Ky partneritet parashikohet të jetë në fusha të tilla si shkëmbimi i informacionit, trajnime,veprimtari të përbashkëta audituese rajonale, etj.¹²Për vitin 2013, KLSH ka nënshkruar marrëveshjen me ACA (Gjykata Austriake e Auditimit) dhe synon nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-t e Bavarisë, Britanisë së Madhe dhe Norvegjisë, si dhe intensifikim bashkëpunimi me rrjetin e SAI-ve të Evropës Juglindore, ku krahas marrëveshjeve të sipër-cituara, se fundmi janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me SAI-in e Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës.

SIGMA është një nga partneret tanë kryesore dhe ndër më të rëndësishmit jo vetëm për kontributin e tij në monitorimin dhe vlerësimin e përvitshëm të aktivitetit të KLSH, por edhe për ndihmësen thelbësore që ka dhënë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012 me trajnime në fushën e auditimit të performancës, të auditimit financiar, të pajtueshmërisë dhe të teknologjisë së informacionit. KLSH do të vazhdojë bashkëpunimin intensiv me SIGMA përgjatë gjithë vitit 2013 dhe më tej. SIGMA është padyshim një garanci e zhvillimit cilësor të kapaciteteve audituese të institucionit tone.

DG-Budget dhe në tërësi **Delegacioni i BE-se në Shqipëri** janë partnerë shumë të rëndësishëm dhe themelorë të KLSH. DG-Budget ka dhënë kontribut të vyer për përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të institucionit, kontribut i cili kulmoi me pjesëmarrjen aktive të një

¹⁰ Marrëveshjet e Bashkëpunimit me AK, ILDKP, Zyren e Prokurorit të Përgjithshëm dhe me APP (Agjencia e Prokurimit Publik)

¹¹ Bujar Leskaj. Projekt-Ide .Paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë , Tiranë 14 Dhjetor 2011, faqe 12

¹² Marrëveshjet e bashkëpunimit me SAI-t polak, slloven, turk, kroat , austriak, malazes dhe të Bosnje Hercegovines

eksperti të saj në tryezat e punës të organizuara nga KLSH në nëntor 2012 me palët kryesore të interesit për amendimet e ligjit. Delegacioni i BE-së në Shqipëri ka miratuar projektin e binjakëzimit të propozuar nga KLSH në kuadër të fondeve IPA 2013 dhe po tregon një vëmendje të shtuar ndaj rolit dhe kontributit që institucioni mund të luaj në miradministrimin e fondeve publike dhe përmirësimin e qeverisjes në Shqipëri.

Shoqatat profesionale kombëtare vlerësohen nga KLSH si një partner i rëndësishëm, veçanërisht Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) si dhe shoqatat e ndryshme të kontabilisteve. Me IEKA dhe KKK, KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe do të zhvillojë veprimtari me interes të ndërsjellë, kryesisht në propagandimin dhe zbatimin të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit publik, të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me IFAC. Në këtë kuadër, KLSH do të vazhdojë të institucionalizojë bashkëpunimin me organet akademike, sidomos me universitetet në Shqipëri dhe Kosovë dhe rezultatet në këtë drejtim janë konkrete : në muajin qershor 2013, KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Gjeologji Minierave dhe është në pritje të lidhjes së marrëveshjes me Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

7. Mjedisi strategjik

Mjedisi strategjik.

Vlerësimi i mjedisit strategjik konsiston në evidentimin e zhvillimeve strategjike të brendshme e të jashtme që ndikojnë në veprimtarinë dhe zhvillimet e KLSH-se. Disa nga këto zhvillime janë si vijon:

- ☞ Procesi i integritit të vendit tonë në BE pritet të jetë i shpejtë në vitet e ardhshme, gjë e cilat do të shoqërohet me shtimin e financimeve të BE për Shqipërinë. Kjo do të kërkojë që KLSH, përveç përafrimit të legjislacionit, të marrë në konsideratë edhe nevojat për auditimin e këtyre fondeve të BE. Kjo do të kërkojë burime shtesë auditimi, por edhe nivel të lartë të njohurive mbi auditimin e këtyre fondeve;
- ☞ Ligji i ri për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i cili ka hyrë në fuqi vitet e fundit kërkon një qasje të re të auditimit nga KLSH, duke u fokusuar në përgjegjshmërinë menaxheriale të menaxhereve publike. Për rrjedhojë, KLSH pritet të vlerësojë në tërësi proceset e menaxhimit të riskut si dhe bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e ekspozimit të tij;
- ☞ Sistemi i Auditimit të Brendshëm pritet të ketë zhvillime të reja, veçanërisht në zbatimin e standardeve profesionale. KLSH duhet t'i ndjeke këto zhvillime në planin e vlerësimit të veprimtarisë së Sistemit të Auditimit të Brendshëm në përputhje me standardet, në mbështetje të veprimtarisë dhe inkurajimit të pavarësisë së tij, si dhe të përdorimit të punës së Auditimit të Brendshëm. Rëndësia e zhvillimit të këtij sistemi është e trefishtë,

sepse kur ai është cilësor ndikon në përmirësimin e menaxhimit të subjekteve të audituara, kursen drejtpërdrejtë burimet e auditimit të KLSH dhe bëhet faktor në parandalimin e korrupsionit;

- ☞ Ligji i ri i KLSH, sipas variantit të dorëzuar nga institucioni në Kuvend në fund të Nëntorit 2012, pritet të miratohet në fund të vitit 2013, ose në fillim të vitit 2014 parashikon edhe detyrimin e KLSH-së për të dhënë një opinion për raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit dhe të sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm. Ky pozicion i ri i KLSH duhet të shoqërohet me një varg aktiviteteve për rritjen e njohurive të stafit të auditimit për të mundësuar këtë objektiv.
- ☞ Vënia në zbatim e ligjit të ri për KLSH si dhe miratimi i ligjit të ri për Shërbimin Civil kërkojnë disa masa konkrete për certifikimin e stafit të auditimit si dhe ndryshime rrënjësore në procesin e edukimit të vazhdueshëm të stafit. Nga ana tjetër gjendja e burimeve njerëzore të KLSH dhe përafrimi i praktikave e procedurave me këto ligje kërkojnë hartimin e politikave të reja për rekrutimin e stafit, zhvillimin e karrierës, vlerësimin e performancës etj.
- ☞ Procesi i privatizimit të pronës shtetërore ka hyre në fazën përfundimtare dhe ka ecur me shpejtësi vitet e fundit ndërkohe që është shoqëruar edhe me parregullsi dhe akte të tjera të kundër-ligjshme. Në këtë faze kemi përpara privatizime strategjike, të cilat janë të ndjeshme politikisht por edhe bartin rreziqe të konsiderueshme, sikundër ka edhe impakte të rëndësishme në Buxhetin e Shtetit. E lidhur me procesin e privatizimit është edhe forma e bashkëpunimit ose e partneritetit publik dhe privat e cila krahas avantazheve bart edhe rreziqe. Për këtë arsye Kontrolli i Lartë i Shtetit kërkohet të angazhohet të ndjekë hap pas hapi këtë proces, në mënyre që të informojë Kuvendin e Shqipërisë në kohën e duhur për parregullsitë eventuale.
- ☞ Bazuar në strategjinë e qeverisë për qeverisjen elektronike, kanë ndodhur dhe pritet të ndodhin ndryshime të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve publike dhe komunikimin. Veçanërisht zhvillime të tilla si prokurimet elektronike, sistemet elektronike të qeverisjes në tatime dhe në dogana si dhe informatizimi i sistemit të thesarit kërkojnë një qasje të re të auditimit nga ana e KLSH për të mbuluar me auditim këto veprimtari.
- ☞ Progresi i ulet në luftën kundër korrupsionit në vendin tonë dikton nevojën e një angazhimi më të madh të KLSH-së bazuar në rekomandimet e INTOSAI-t duke u fokusuar në analizën e rreziqeve dhe të dobësive të sistemeve që ndikojnë në uljen e këtyre rreziqeve.
- ☞ Ekzistenca akoma e një numri të konsiderueshëm të ndërmarrjeve shtetërore në vartësi të ministrive apo edhe të qeverisjes lokale si ato në fushën e energjetikës, ujësjellës-kanalizimeve, ndërmarrjet e portit detar, hekurudhave, shërbimeve pyjore etj konsiderohen si zona me rrezik të lartë dhe do të kërkojnë një vëmendje në rritje të KLSH.
- ☞ Procesi i decentralizimit fiskal është një proces që po ecën me shpejtësi. Sipas strategjisë përkatëse të qeverisë, pjesa e taksave që mblidhen nga qeveria pritet të zvogëlohet nga

viti në vit duke ja kaluar të drejtën për t'i mbledhur dhe përdorur ato strukturave të qeverisjes vendore. Kjo duhet të shoqërohet me angazhime të veçanta të KLSH për të audituar mbledhjen dhe përdorimin e tyre duke ndikuar kështu burimet e auditimit dhe ndryshime organizative eventuale.

8. Rezultatet e Analizes së Pengesave:

Që nga projekti i binjakëzimit me NAO-n e Britanisë së Madhe dhe Gjykatën e Auditimit të Holandës, e cila përfundoi në fillim të vitit 2008, procesi i zhvillimit të KLSH sipas standardeve të INTOSAI u ngadalësua shumë dhe arriti deri në bllokim në vitin 2011. Në vitin 2012, menaxhimi i ri i KLSH ka nisur një program ndryshimi dhe ka investuar në amendimin e Ligjit të KLSH në mënyrë që të siguroj pavarësinë e tij, në trajnime intensive për të gjithë audituesit në të gjitha llojet përkatëse të auditimit (Auditimi i Performancës, Auditimi Financiar, Auditimi i Pajtueshmërisë, Auditimi i TI), si dhe në bashkëpunimin me organizata auditimi kombëtare dhe ndërkombëtare (të brendshëm dhe të jashtëm). Një pjesë e konsiderueshme e stafit të KLSH është nxitur nga ndryshimi në stilin e menaxhimit dhe ka treguar gatishmëri për të kontribuar në ndryshimet përpara. Një analizë e mangësive ka rezultuar në vëzhgimet e mëposhtme. Dobësia kryesore e KLSH është niveli i pamjaftueshëm profesional i auditimeve dhe situata e pakënaqshme nga mbështetja e stafit. Kjo nënkupton një rrezik të madh që interesi publik dhe besimi ndaj KLSH të ulet dhe KLSH nuk do të jetë në gjendje të realizojë vizionin e tij. Burimet njerëzore kanë një zhvillim të paket, 57% e punonjësve janë mbi 50 vjeç dhe 11% e tyre janë mbi 60 vjeç, me mangësi në drejtim të plotësisht të nevojave për trajnim gjatë 3 viteve të fundit. Teknologjia e informacionit në KLSH dhe përdorimi i saj për qëllime të auditimit, kanë një zhvillim të pamjaftueshëm. Më kryesorja, situata aktuale buxhetore e KLSH nuk lejon rritjen e numrin të punonjësve dhe të fondeve për investime për modernizimin e TI. Gjithashtu, ka pasur dhe akte nën-ligjore rregullative të pamjaftueshme, si dhe procedura të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë jo të përshtatshme.

Analiza e pengesave tregoi gjithashtu se ka mundësi inkurajuese për të kapërcyer dobësitë. Vërehet një mbështetje politike për të ndryshuar ligjin e propozuar nga menaxhimi i KLSH. Një mbështetje financiare e BE në vlerën prej 2.1 milion euro, brenda kornizës së Projektit të Binjakëzimit IPA 2013, i cili tashmë është miratuar dhe ndodhet në procedurat e përgatitjes për tenderim, duke krijuar kështu mundësinë për të mbështetur zhvillimin institucional dhe kapacitetet audituese nga viti 2014. Bashkëpunimi i vendosur me institucionet homologe dhe ndihma e tyre profesionale, do të krijojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e KLSH; dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, mbështetja e Kuvendit për KLSH dhe sidomos mbështetja e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, mund të krijojë mundësi për të rishqyrtuar buxhetin dhe për pasojë për të përmirësuar situatën e stafit të institucionit. Megjithatë, ka edhe disa rreziqe që mund të pengojnë zhvillimin e KLSH sipas këtij plani, pavarësisht frymës së menaxhimit dhe

mundësive të ofruara. Mos miratimi i amendimeve të ligjit në kohë është një rrezik, i cili duhet të merret parasysh edhe pse mundësia e ndodhjes është mjaft e ulët për shkak se ndryshimet e ligjit janë pjesë e kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Një rrezik tjetër është dhe shtyrja e projektit të binjakëzimit ose një reduktim i buxhetit të saj. Megjithatë edhe kjo mundësi është mjaft e vogël, pasi buxheti është miratuar dhe sipas procedurave të BE-së nuk do të ndryshojë më. Shtyrja e fillimit të projektit të Binjakëzimit është e mundur për shkak të kërkesave procedurale, por ky rrezik mund të zbutet nga reagimet e menjëhershme të KLSH. Kërcënimi kryesor për zhvillimin e KLSH, është zhvillimi i burimeve të tij: financiare dhe njerëzore. Mjetet financiare të KLSH të akorduara nga buxheti i shtetit janë të kufizuara. Nëse këto mjete do të jenë edhe më të kufizuara në të ardhmen, kjo do të ketë pasoja negative për zhvillimin e tij të mëtejshëm në një SAI modern, si dhe në zbatimin e këtij Plani të Zhvillimit Strategjik. Lidhur ngushtë me financimin buxhetor të KLSH, është i nevojshëm zhvillimi cilësor i aftësive profesionale të stafit. Pa një përkrahje të konsiderueshme financiare nga Buxheti i Shtetit ose nga donatorët e jashtëm, ekziston një rrezik i konsiderueshëm që zhvillimi profesional i personelit të pengohet, i cili padyshim do të ketë efekt mbi angazhimin që kërkohet nga i gjithë stafi i KLSH në zbatim të këtij PZHS.

9. Objektivat strategjike

Në bazë të misionit, vizionit, mandatit, analizës së pengesave dhe mjedisit strategjik, si dhe duke marrë parasysh situatën në drejtim të burimeve, KLSH ka vendosur këto objektiva strategjike për periudhën 2013-2017. Në përcaktimin e tyre, KLSH është frymëzuar nga katër objektivat themelore të Strategjisë së Zhvillimit 2011-2017 të EUROSAT, të cilat janë:

1. Ngritja e kapaciteteve;
2. Standardet profesionale;
3. Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës; dhe
4. Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe efektive të komunikimit

Objektivi Nr. 1. Zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH. Amendimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane

KLSH në veprimtarinë e saj të auditimit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjet e shtetit shqiptar dhe në Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI. Zhvillimi institucional i referohet forcimit të kapaciteteve institucionale, duke u bërë një institucion model i qeverisjes së mirë në sektorin publik. KLSH synon të krijojë një model të qeverisjes së mirë brenda institucionit, nëpërmjet rritjes së transparencës së veprimtarisë së saj, pjesëmarrjen e palëve të interesuara, përdorimin ekonomik dhe efikas të burimeve, promovimin e përgjegjësisë individuale dhe institucionale, krijimin e një kulture të pa tolerueshme për konfliktin e interesit, parregullsisë dhe mashtrimit. Nga ana tjetër, institucioni do të aplikojë një qasje fleksibël për interesat e mjedisit të jashtëm, duke marrë parasysh kërkesat e mjedisit të jashtëm të institucionit.

Nën-Objektivi 1.1: Lobim që amendimet të miratohen në Kuvend

Institucioni ka paraqitur zyrtarisht në Kuvend ndryshimet në ligjin e tij organik nr. 8270 dt. 23.12.1997, (i ndryshuar). Këto ndryshime pritet të miratohen brenda vitit 2013 ose në fillim të vitit 2014. Ato përcaktojnë përgjegjësitë e reja në fushën e auditimit, cilësojnë të drejtat dhe detyrimet e institucionit bazuar në standardet INTOSAI, si dhe organizimin dhe strukturën, statusin e personelit, procesin e certifikimit të pasqyrave financiare të subjekteve të audituara, certifikimin e audituesve, etj. Zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një sërë ligjesh të cilat janë të lidhura me menaxhimin e procesit të auditimit dhe institucionit si një e tërë. Në frymën e Deklaratës së Limës, Deklaratës së Meksikës dhe Rezolutës së Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011, të cilat kërkojnë pavarësinë e plotë të Institucioneve Supreme të Auditimit kundër ndikimeve të jashtme, në periudhën 2013-2017, plani strategjik i KLSH do të përpiqet të forcojë pavarësinë institucionale, funksionale dhe të audituesve të tij. Në këtë kontekst, KLSH është e angazhuar për të plotësuar kuadrin rregullator në mënyrë që të sigurojë pavarësinë e institucionit të tij, duke përfshirë pasojat e ndryshimeve të ligjit dhe të ndryshojë mekanizmat e brendshëm që sigurojnë pavarësinë e audituesve në vlerësimin e planifikimit dhe raportimin e auditimeve.

Nën-Objektivi 1.2: Rregullat e brendshme do të duhet të zhvillohen në disa fusha

Menaxhimi i lartë i KLSH duhet të aplikojë një stil të hapur dhe profesional në të gjitha nivelet e ulta të menaxhimit dhe ekzekutimit dhe duhet të përcjellë këtë filozofi në të gjithë organizimin institucional. Strukturat pritet të jenë fleksibël dhe të thjeshta në mënyrë që të lejojnë komunikimin dhe të lehtësojnë procesin e vendim-marrjes. Menaxhimi i burimeve të auditimit dhe vlerësimi i performancës së tyre, do të jenë subjekt i rregullave dhe procedurave moderne në mënyrë që të rrisin cilësinë dhe efikasitetin e funksioneve të tyre për të përmbushur misionin e KLSH, e cila do të zhvillojë dhe zbatojë rregullat për dokumentimin e kohës së auditimit në bazë të përvojave të mira evropiane.

Do të projektohet një strukturë e re organizative, duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e njësisive ekzistuese dhe duke shtuar të reja, nëse kërkohet, në mënyrë që të sigurohet përdorim sa më i mirë i burimeve, duke ulur koston e procedurave administrative.

"Si vendoset theksi"? Përcaktimi i strategjisë për përmbushjen e standardeve etike dhe cilësisë; komunikimi i strategjisë brenda dhe jashtë; miratimi i standardeve ndërkombëtare mbi kontrollin e cilësisë; rekrutimi i një stafi kompetent dhe të kualifikuar dhe shqyrtimi dhe vlerësimi i zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë "¹³

KLSH do të vendosë rregulla të qarta për rekrutimin e një stafi kompetent me vlera të larta profesionale dhe etike dhe do të motivojë dhe kontribuojë në misionin dhe objektivat strategjike të KLSH. Kjo gjë do të hapë rrugën për përmirësimin e sistemit të rekrutimit të stafit, trajnimit e

¹³ Prezantim i Prof Assoc. Rejai Akyel, Kryetari i Gjykatës së Llogarive të Turqisë në Konferencën VII-të EUROSAL-OLACEFS në Tbilisi, Gjeorgji, tetor 2012, fq. 17.

vazhdueshëm dhe studime specializimi të nivelit pasuniversitar, si dhe krijimin e një sistemi profesional të certifikimit.

Institucioni do të përgatisë një Manual të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për stafin, i cili do të përfshijë çështje që lidhen me përshkrimin e punës dhe përgjegjësi, raportimin, politikat dhe procedurat për rekrutimin dhe zhvillimin e karrierës, vlerësimin e performancës, të promovimit, rregullat e brendshme, sjelljen në punë dhe çështje të tjera bazuar në menaxhimin e burimeve njerëzore në KLSH.

Nën-Objektivi 1.3: Intensifikimi i komunikimit me Kuvendin

Sikurse është përmendur me lart, Kuvendi është një partner kyç strategjik i KLSH. Institucioni ka komunikuar me Kuvendin kryesisht nëpërmjet Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit. Ky komunikim ka qenë korrekt dhe institucional deri tani. KLSH, për intensifikimin e komunikimit me Kuvendin do të përgatisë një modeli raportimi për Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Kuvendin e Shqipërisë, për rezultatet e auditimeve të rëndësishme dhe që paraqesin interes për Qeverinë dhe taksapaguesit.

Objektivi Nr. 2: Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit

KLSH do t'i përmirësojë kapacitetet, cilësinë dhe produktivitetin e auditimeve të tij në kushtet e një veprimtarie me burime të kufizuara dhe të angazhimit për t'ju përmbajtur Standardeve Profesionale Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, bazuar në standardet IFAC.

Institucioni do të përfitojë nga potenciali i auditimit të performancës, duke realizuar rritjen e kontributit dhe të profilit të tij në menaxhimin e fondeve publike. Ai do të përballë me sfidën e detyrimit të ri për të dhënë një opinion të auditimit mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar të Shtetit.

Prandaj, KLSH do të shqyrtojë rialokimin e burimeve të tij të auditimit, të cilat përdoren aktualisht për auditime të pajtueshmërisë duke aplikuar një qasje moderne, tërësisht të shmangur nga lloji i auditimeve të inspektimit dhe ngritjen e sistemit të orientuar të auditimeve të pajtueshmërisë, të cilat kanë të ngjarë të kenë potencial për të ushtruar një ndikim të madh, duke kursyer burimet në të njëjtën kohë.

Nën-Objektivi 2.1: Modernizimi i qasjes së auditimit të pajtueshmërisë

Qasja për auditimin e pajtueshmërisë do të rishikohet; programimi dhe planifikimi do të bazohen në vlerësimin e rrezikut, përzgjedhjen statistikore të kampionit që do të aplikohet në auditime,

raportimin që do të përqendrohet në gjetjet sistematike dhe jo mbi rastet individuale të mospajtit.

Qasja në rishikimin e auditimit të pajtueshmërisë do të përcaktoje një manual të auditimit të pajtueshmërisë, në pajtim me standartet ndërkombëtare 4000 - 4200 dhe trajnimi do të organizohet në bazë të qasjes së re. Burimet e periudhës së planifikimit për auditimin e pajtueshmërisë do të zvogëlohen; do të kryhet një analizë e ngarkesës së punës aktuale, e cila do të jetë objektivi bazë për këtë zvogëlim.

Nën-Objektivi 2.2: Zhvillimi i kompetencave të auditimit financiar dhe të kapaciteteve

Ndryshimet në ligjin e KLSH nënkuptojnë se KLSH duhet të paraqesë në Parlament një raport vjetor me opinionin e saj mbi deklaratën përfundimtare buxhetore të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe përfundimet e auditimit.¹⁴

KLSH duhet të përgatisë veten për lëshimin e një opinionin mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar dhe dhënien e opinionëve mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara. Kjo nënkupton një rishikim të një manuali të auditimit financiar, duke përfshirë edhe udhëzime mbi opinionet e auditimit dhe të raportimit dhe trajnimin e audituesve të përzgjedhur në këtë fushë.

Nën-Objektivi 2.3: Zhvillimi i auditimit të integritetit

Auditimi i integritetit, si risi e llojeve të auditimit në vitet e fundit, po shtrihet gjithnjë e më shumë në SAI-t e zhvilluara dhe në komunitetin INTOSAI. KLSH, në kuadrin e projektit të binjakëzimit IPA 2013, do të hartojë, me ndihmën e ekspertëve të huaj, Manualin e Auditimit të Integritetit në njësitë e sektorit publik. Institucioni do të trajtojë një staf të përzgjedhur nga audituesit e vet me të afte në drejtim të rritjes së kapaciteteve për realizimin e këtij auditimi.

KLSH është anëtare e Grupit të Punës së INTOSAI për auditimin e integritetit në subjektet e audituara dhe do të angazhohet në të ardhmen në realizimin dhe shtimin e numrit të auditimeve të integritetit, si një veprimtari që rrit përgjegjshmërinë në administrimin e fondeve publike dhe parandalon ose kufizon mashtrimin financiar dhe korrupsionin në njësitë që auditohen.

Nën-Objektivi 2.4: Zhvillimi i auditimit të menaxhimit të fondeve të BE

Me perspektiven e qarte të marrjes nga Shqipëria të statusit të vendit kandidat për në BE dhe të rritjes së asistencës teknike të Bashkimit Evropian dhe të projekteve me fondet e BE për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë, KLSH do të punojë të rrisë njohuritë dhe kapacitetet e audituesve të tij për kryerjen e plotë të auditimit të menaxhimit të fondeve të BE. Ky auditim do

¹⁴ Draft-ligji I KLSH, neni 24a

të shohë menaxhimin e fondeve të akorduara nga BE nga këndvështrimi i efektivitetit të ndihmës së dhënë institucioneve publike përfituese. Rritja e kapaciteteve të audituesve të KLSH do të arrihet nëpërmjet trajnimeve specifike për këtë temë nga eksperte të SIGMA, si dhe nga eksperte të SAI-ve partnere të KLSH, nëpërmjet trajnimeve apo shkëmbimeve të eksperiencës së ngjashme në vendet përfituese të ndihmës së BE. Në një të ardhme (mbas ndryshimeve të ligjit organik të KLSH), mund të realizohet edhe pjesëmarrja e eksperteve të huaj në auditime specifike.

Nën-Objektivi 2.5: Hyrje në programimin e auditimit bazuar në rrezik

KLSH do të përgatisë programin e saj vjetor të auditimeve të bazuar në një analizë të rrezikut të subjekteve të audituara. Ajo do të përgatisë një udhëzues të veçantë për programin vjetor të auditimit, të cilat do të reflektojnë qartë fushën e auditimit, duke renditur subjektet publike nën juridiksionin e KLSH, si dhe do të krijojë një baze të dhënash për auditimet dhe metodat e përdorura për të zgjedhur subjektet, në mënyrë që të shmanget tërësisht mbivendosja me auditimet e Njësive të Auditimit të Brendshëm.

Nën-Objektivi 2.6: Zhvillimi i udhëzimeve të materialeve specifike të auditimit

KLSH do të rrisë kapacitetet e auditimit, për auditimin e mashtrimit financiar dhe auditimin e integritetit, duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e audituesve në këtë proces, si dhe rregullimin e marrëdhënieve që lindin me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit gjatë auditimit të mashtrimit financiar, gjë që do të konkretizohet në materialin udhëzues specifik. Duke pasur parasysh dobësitë e vërejtura në vitet e mëparshme, institucioni do të zhvillojë udhëzime lidhur me raportimin e auditimit, duke synuar strukturimin e raporteve bazuar në mesazhet që ata duhet të ndjekin dhe të japin. KLSH do të përmirësojë strukturën e raporteve të auditimit, duke futur formulimin e një përmbledhje ekzekutive, prezantimin e gjetjeve selektive, duke përdorur metoda dhe gjuhën grafike, si dhe formulimin e rekomandimeve të qarta. Formatit dhe struktura e raporteve që i dërgohen çdo vit Kuvendit do të rishikohet, me qëllim për të zvogëluar natyrën voluminoze të informacionit dhe fokusimin në dhënien e mesazheve.

Përmirësimi i rekomandimeve të auditimit dhe opinionet e dhëna nga KLSH, do të jenë një drejtim tjetër i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së auditimit. Kjo do të ndihmojë audituesit të përqendrohen për të dhënë rekomandime me ndikim të lartë mbi objektivat e njësisë ekonomike dhe përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në formulimet e mendimeve të qarta dhe provave të bazuara. Ndërkohë, ndjekja e rekomandimeve kërkon një skemë të re dhe një vëmendje më të madhe, duke aktivizuar të gjitha mekanizmat e mundshme për zbatimin e tyre. Gjithashtu, do të zhvillohen udhëzime për ndjekjen e rekomandimeve, si dhe një sistem për të ndjekur sistematikisht zbatimin e rekomandimeve.

Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, audituesit e KLSH do të përqendrohen në veçanti në metodat, teknikat dhe komponentët e vlerësimit të këtij sistemi. KLSH do të përqendrohet në inkurajimin dhe mbështetjen e vlerësimit të auditimit të brendshëm,

si dhe bashkëpunimin dhe përdorimin e punës së auditimit të brendshëm, kur ky i fundit plotëson standardet e tij profesionale.

DG Budget shprehet: "Auditimi i jashtëm publik dhe auditimi i brendshëm, kanë një rol kyç në mekanizmin e mbrojtjes së financave publike. Duke pasur një objektiv të njëjtë, ata kanë qëllime dhe funksione raportuese të ndryshme"¹⁵

Nën-Objektivi 2.7: Forcimi i rolit të Departamentit për Kërkimin Shkencor, Zhvillimin dhe TI në KLSH për hartimin e metodologjive dhe aktiviteteve të lidhura të trajnimit

Në të ardhmen, duke vazhduar pa ndërprerje ciklin e suksesshëm të botimeve të vitit 2012, furnizimi me material i stafit të KLSH për ngritjen profesionale dhe nëpërmjet trajnimeve do të jetë i domosdoshëm. Departamenti për Kërkimin Shkencor, Zhvillimin dhe Teknologjinë e Informacionit do të punojë ngushtësisht me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Njësinë e Trajnimeve brenda saj për përgatitjen e manualeve të rinj ose përditësimin e manualeve ekzistues për auditimin, si dhe do të orientojë programin e trajnimeve me tema të përzgjedhura nga praktikatat e mira të SAI-ve partnere të KLSH dhe nga aktivitetet e IDI, EUROSAI dhe INTOSAI.

Nën-Objektivi 2.8: Zhvillimi i trajnimeve profesionale

Kapacitetet audituese të stafit të KLSH-se do të forcohen kryesisht nëpërmjet rritjes së njohurive individuale të stafit. Në amendimet e ligjit organik të KLSH, të cilat priten të miratohen së shpejti, është parashikuar certifikimi profesional i stafit auditues. Ky proces do të kontribuojë në krijimin e një trupe profesionale audituesish, të aftë të përballojnë misionin e institucionit dhe të realizojnë vizionin nëpërmjet kryerjes së auditimeve profesionale. Procesi kërkon hartimin e miratimit të rregullave e procedurave të veçanta për realizimin e tij, në mënyre të drejtë dhe transparente. Ai mund të kërkojë riklasifikimin e pozicioneve të audituesve në përputhje me njohuritë që priten të fitojnë audituesit, të cilat do të testohen përpara një komisioni kompetent.

KLSH do të përqendrohet në përcaktimin e njohurive të audituesve sipas llojeve të auditimit, si një çështje që kërkon një vëmendje të veçante dhe është pjesë e vlerësimeve dhe analizave paraprake në përputhje me misionin e institucionit. Institucioni do të hartojë me kujdes modulet e trajnimit, do të kryejë përzgjedhjen e trajnerëve, mbi bazën e një bashkëpunimi efektiv me qarqet akademike, me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, me IEKA, KKK, etj.

Përvetësimi i njohurive më të përparuara mbi auditimin do të kryhet duke përdorur edhe mjete të tilla si auditimet pilot për çështje që janë me tipike ose paraqesin risi (p.sh. auditimi Teknologjisë së Informacionit) apo për subjekte komplekse. Transmetimi i përvojës së fituar nëpërmjet këtyre auditimeve do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të workshop-eve dhe seminareve njohës me stafin, si dhe nëpërmjet publikimit të tyre në faqen e internetit.

¹⁵ Z. Robert Gielisse, Drejtor i Njësisë së DG-Budget, Prezantim në tryeza të rrumbullakëta për të diskutuar Ligjin e Ri të KLSH, Tiranë, nëntor 2012, f. 6.

Rritja e njohurive të stafit do të sigurohet të bëhet në mënyre të vazhdueshme edhe pas certifikimit të audituesve. KLSH do të vijojë të mbaje një normë të lartë trajnimi për stafin, të vendosur në vitin 2012, me 19.4 dite trajnimi në vit për audituesit me eksperiencë dhe 25 ditë trajnimi në vit për të rinjtë. Institucioni do të hartojë një strategji sektoriale për trajnimin e burimeve njerëzore me të gjithë elementet e saj, ku do të përfshihet rritja e profesionalizmit të stafit përmes studimeve pasuniversitare në nivel masteri apo doktorature, ndjekjes së studimeve universitare në dege të dyta, përmirësimit të nivelit dhe zgjerimit të audituesve që njohin gjuhën e huaj (kryesisht anglisht) dhe shfrytëzimin e materialeve dhe studimeve në gjuhë të huaj. Krahas çështjeve të trajtuara më sipër, KLSH do të institucionalizojë përfundimisht politikën e reja të rekrutimit dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore, të zbatuara me intensitet gjatë vitit 2012, si dhe në respekt të faktorëve të tjerë të mjedisit strategjik të KLSH-se, të cilët kërkojnë me përparësi sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare të institucionit për zhvillimin e trajnimeve.

Nën-Objektivi 2.9: Zhvillimi i kontrollit të cilësisë në auditim

Kontrolli i Lartë i Shtetit e konsideron cilësinë e auditimit si jetike për kryerjen e misionit të tij, për imazhin dhe besueshmërinë e institucionit të publiku dhe Kuvendi. Për këtë, institucioni do të përmirësojë skemën për menaxhimin e cilësisë, e cila përfshin shqyrtimet në të ftohtë dhe në të nxehtë. Kjo skemë e përmirësuar do të ketë ndikim të padiskutueshëm në rezultatet e auditimit dhe në kapacitetin institucional, si dhe do t'u japë një rol më të madh niveleve përkatëse menaxheriale të auditimit, duke u shoqëruar me përgjegjësitë e tyre për produktet e auditimit. Skema duhet të kombinojë rolin e menaxhereve me pavarësinë e audituesve në dhënien e opinionëve, duke e ruajtur thellësisht atë, por duke forcuar paralelisht edhe përgjegjësitë e audituesve për besueshmërinë e raporteve të prodhuara prej tyre. Kjo skemë do të përfshijë më dukshëm procesin e menaxhimit të cilësisë së auditimit në të gjitha fazat e auditimit, që nga programi i auditimit deri të ekzaminimi dhe raportimi. Ajo do të japë sigurinë e plotë të vendim-marrësve mbi besueshmërinë e raporteve të auditimit. Për këtë, grupe pune ad hoc do të kompletojnë një raport vjetor mbi cilësinë e auditimeve të kryera, si dhe ekspertë të jashtëm do të pajtohen për të vlerësuar cilësinë e auditimeve të kryera.

Nën-Objektivi 2.10 “Pjesëmarrje aktive e KLSH në programin “3i””.

KLSH ka nënshkruar Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të IDI dhe EUROSAI për Programin “3i”, Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve.

IDI (Instituti i Zhvillimit Ndërkombëtar i INTOSAI) ka zhvilluar Programin e quajtur “3 i-të”, i cili nënkupton Nismën e Implementimit të standardeve ISSAI. Në kuadër të këtij programi, vendet anëtare të IDI, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria, angazhohen për të hartuar Strategji, të cilat sigurojnë jo vetëm përshtatjen e Standardeve ISSAI, por mbi të gjitha pajtueshmërinë në implementimin e tyre.

Kjo marrëveshje nënkupton angazhimin e tre palëve : SAI-t, IDI dhe EUROSAT për implementimin e ISSAI-ve në nivel kombëtar, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Strategjisë për implementim.

Angazhimet e KLSH në kuadër të marrëveshjes janë:

1. Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësi të Moderatorëve , të cilët do të udhëheqin procesin e implementimit të ISSAI – ve në nivel kombëtar;
2. Kryerja e vlerësimeve mbi pajtueshmërinë e ISSAI-ve, me ndihmën e Moderatorëve të ISSAI deri në fund të Dhjetorit 2013;
3. Hartimi i Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve, duke përfshirë gjetjet e “iCAT-s” (Mjetet e Vlerësimit të Pajtueshmërisë me ISSAI-t) dhe hartimin e një Plani Veprimi për implementimin e Strategjisë deri në Mars 2014.

Kryetari i KLSH me datë 24.06.2013 ka nxjerrë Urdhrin përkatës dhe brenda Dhjetorit 2013, institucioni do të realizojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke u angazhuar intensivisht në përmbushjen e angazhimeve.

Objektivi Nr. 3. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës

Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës përben një nga sfidat më madhore të KLSH. Auditimi i performancës i institucionit në vitin 2017 do të jetë një veprimtari e konsoliduar, me një vëllim të katërfishuar të numrit aktual të auditimeve të performancës (të vitit 2012), me një staf të mirë-trajnuar që ka demonstruar aftësi të spikatura në kryerjen e këtij lloji auditimi me ndikim në administratën publike shqiptare. Auditimi i Performancës do të jetë një nga dy aktivitetet më të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e institucionit.

Ekonomia e vendit në këtë situatë delikate të ekonomisë botërore, sidomos asaj të Eurozonës, por edhe e gjithë shoqëria shqiptare kanë nevojë për sigurimin e shërbimeve publike nga përdorimi me ekonomikitet, me efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike. Auditimi i performancës jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Gjithashtu, nxjerrja në pah e ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në mënyre direkte ose jo i ndihmon entet shtetërore për të vlerësuar veten dhe matur rezultatet e tyre, për të përcaktuar (gjetur) mundësi të tjera për rritjen e rezultateve me të njëjtën kosto. Në mënyrë më specifike, KLSH do të këshillojë dhe ndihmojë drejtuesit dhe personelin e këtyre enteve për përmirësimin e proceseve të punës, sidomos aty ku efikasiteti është e vështirë për t'u matur, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike pa rritur shpenzimet.

Në Projekt-Idenë e paraqitur me datë 14 Dhjetor 2011 në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financës së Kuvendit, Kryetari i KLSH z. Leskaj theksoi se: “KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të

përgjegjshmërisë publike. Përqendrimi i vëmendjes tek auditimi i performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik 2013-2017 të KLSH¹⁶.

Përballimi i kësaj sfide dhe realizimi i objektivit të parashikuar kërkon rritjen e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës nga viti në vit dhe në mënyrë graduale, në përputhje me burimet e krijuara të auditimit. Në shtator të vitit 2012, u krijua Departamenti i Auditimit të Performancës, i përbërë nga 16 auditues, ndër të cilët ka auditues më përvojë në KLSH dhe auditues të rinj me të dhëna premtuese.

Rezultatet zhgënjyese të disa politikave publike tregojnë një hendek mes qëllimeve të politikave dhe skemave në njërën anë, dhe kompleksit dhe natyrës gjithnjë në ndryshim të problemeve shoqërore dhe ekonomike të vendit në anën tjetër. Ato kërkojnë një tip të ri përgjegjësie, në të cilën auditimi i sektorit publik duhet të luajë rolin e tij duke marrë një qasje dinamike më tepër se sa një qasje statike. KLSH do përqendrojë auditimin e performancës pikërisht dhe kryesisht në rezultate, më tepër se sa në proces, duke theksuar nevojën për ndryshim, për përmirësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm të menaxhimit publik. Institucioni ka sfidën që të konsiderojë nëse synimet e politikave dhe skemat lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit.

INTOSAI njeh nevojën për auditime të performancës që lejojnë më shumë kompleksitet. Udhëzimet e reja të auditimit të performancës në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 3000) nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve: ndikimi aktual i aktiviteteve krahasuar me ndikimin që synohej, duhet të auditohet. Ndryshe nga auditimi i pajtueshmërisë, audituesit e performancës nuk do të shikojnë vetëm nëse programet politike janë duke u realizuar sipas planit, as do të përqendrohen shumë hollësisht nëse objektivat janë arritur, kriteret janë plotësuar, dhe treguesit e performancës janë arritur. Sipas ISSAI 3000, "progresi dhe praktikat duhet të ndërtohen nga të mësuarit mbi përvojën." Audituesit e performancës të KLSH do të punojnë mbi përvojën e deritanishme dhe njëkohësisht do të jenë kurajozë e krijues, duke matur në çdo rast interesin publik në performancën e entit shtetëror që auditohen. Kjo do të lejojë një zhvillim gradual të auditimit të performancës.

KLSH gjatë vitit 2012 ka realizuar katër auditime të performancës, duke rritur ndjeshëm numrin e këtij lloji auditimi, në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2013 institucioni do të realizojë 10 auditime performance.

KLSH ka përfunduar përditësimin tërësor të Manualit ekzistues të Performancës, i cili është botuar në fund të vitit 2012. Zhvillimet e metodologjive specifike që lidhen me auditimin e performancës janë të domosdoshme për realizimin e këtij objekti. Kjo masë do të zgjidhë procedurat e përzgjedhjes së subjekteve për të kryer një auditim performance, planifikimit të auditimit të performancës, teknikave të auditimit dhe mbledhjes së të dhënave, për të kompletuar auditimet e performancës, si dhe çështje specifike që kanë të bëjnë me objektivat, kontrollin e cilësisë, raportimin dhe rekomandimet e auditimit të performancës. Hapat që do të ndërmerren në

¹⁶ Dr.Bujar Leskaj. Projekt-Ide .Paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë , Tiranë 14 Dhjetor 2011 faqe 9

këtë drejtim kanë të bëjnë me krijimin e një skeleti standard për auditimin e performancës, duke synuar përfshirjen në auditim të literaturës bashkëkohore mbi fenomenin apo subjektin që po auditohet, legjislacionin e BE-së në fushën që po auditohet, bazën ligjore vendase, auditimet e kryera nga SAI të tjera të suksesshme, etj. Po kështu, do të synohet aplikimi i metodave shkencore financiare, statistikore dhe ekonometrike për një auditim performace që me të vërtetë ndihmon në përmirësimin e përdorimit të fondeve publike.

Për të realizuar objektivin e mësipërm, Departamenti i Auditimit të Performancës së KLSH, do të përcaktojë çdo vit kriteret në përzgjedhjen e fushave të auditimit. Kriteret e përzgjedhjes do të reflektojnë lidhjen me situatën aktuale të zhvillimit në vend, sfidat e sektorit publik, përmirësimin e treguesve makroekonomikë dhe rritjen e bashkëpunimit me SAI-t e tjerë për të kryer auditime të përbashkëta.

Programe të veçanta trajnimi do të hartohen dhe zbatohen për të kompletuar njohuritë e stafit në lidhje me auditimin e performancës, ndërkohë që gjatë vitit 2012 janë programuar dhe kryer vizita studimore dhe trajnime për auditimin e performancës në SAI-t homologe të Polonisë, Sllovenisë dhe Turqisë. Këto vizita studimore dhe programe trajnimi do të vazhdojnë me intensitet dhe diversitet në vitet në vijim.

Objektivi Nr. 4. Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim

Si në aspektin e burimeve njerëzore ashtu dhe në aspektin e infrastrukturës dhe mjeteve, KLSH nuk ka zhvillimin e duhur në fushën e TI. Njohja e Teknologjisë së Informacionit në KLSH, është shume e kufizuar.

Nën-Objektivi 4.1: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve te TI

Gjatë vitit 2013, KLSH do të krijojë një rrjet të brendshëm të komunikimit elektronik, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi dhe të zvogëlohen kostot aktuale të komunikimit nëpërmjet dokumenteve të shtypura.

Në KLSH ka një nevojë për të ndërtuar një bazë të dhënash dhe një program kompjuterik komunikimin interaktive të asistuar. Kjo platformë virtuale e komunikimit do të jetë referencë e përbashkët e audituesve dhe duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që audituesit të bashkojnë njohuritë, të shkëmbejnë të dhëna dhe të kontribuojnë me ide dhe sugjerime në auditimet e tjera. Ky është një objektivi madhor i aktiviteteve tona, pasi auditimi synon të përmirësojë performancën e përgjithshme të punës, duke vepruar si një faktor i jashtëm në një proces të punës. Kjo është një sfidë e madhe, sepse audituesi duhet të njohë subjektin e audituar. Një mënyrë për të mbyllur këtë hendek është pikërisht përfshirja e shumë këndvështrimeve dhe

"përballja me çështjen" në të njëjtën kohë edhe nëpërmjet një sistemi të tillë komunikimit duke asistuar me kompjuter dhe grumbulluar njohuritë e përbashkëta të të gjithë institucionit.

Nën-Objektivi 4.2: Zhvillimi i auditimit TI

Në këtë fushë të auditimit, institucioni është ende në fillimet e tij. KLSH synon të bëjë ndryshime themelore në përdorimin e teknologjisë së informacionit në punën e tij audituese dhe lehtësimin e personelit, i cili do të reflektohet në rritjen e diturisë dhe shkathtësive të stafit të tij të auditimit.

Për shkak se subjektet publike që auditohen kanë shtrirë në një masë të konsiderueshme përdorimin e TI, institucioni në punën e tij audituese do të vlerësojë përdorimin e saj nga pikëpamja e saktësisë së informacionit që ajo gjeneron, e mbrojtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara, etj. Nga ana tjetër, nevoja e përdorimit të TI për qëllime auditimi është evidentuar si nevojë prioritare.

Realizimi i këtij objektivi kërkon hartimin e metodologjisë për auditimin e TI, përzgjedhjen e një stafi kompetent dhe trajnimin e tij të vazhdueshëm në këtë fushë. Për këtë nevojitet shtimi i stafit në përgjithësi.

Hartimi i një moduli trajnimi të veçantë në lidhje me TI do të kryhet duke u mbështetur tërësisht në trajnimet e SIGMA dhe të SAI-ve polak, slloven dhe kroat. Ai do të përmbajë jo vetëm njohuritë bazë, por edhe njohuritë për rrjetet e brendshëm, për programet bazë të kontabilitetit të informatizuar, për transferimet elektronike të fondeve, sistemet e sigurisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, njohuritë mbi programet e informatizuar të thesarit, doganave, tatimeve si dhe trajnime për implementimin e metodologjive të auditimit të teknologjisë së informacionit.

Objektivi Nr. 5. Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit

Situata e korrupsionit në vendin tonë dikton nevojën e angazhimit të të gjithë institucioneve dhe shoqërisë për të krijuar një front unik kundër këtij fenomeni që kërcënon seriozisht progresin e Shqipërisë. Sipas Raportit të Progresit 2012 të BE-së për Shqipërinë, *“Korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem veçanërisht serioz...Zbatimi i strategjisë antikorruption dhe i masave specifike në sektorë dhe fusha të ndryshme sipas Planit të Veprimit 2011-2013 ka vijuar, edhe pse i ngadaltë...Ka pasur progres të kufizuar në lidhje me kuadrin institucional dhe vendosjen e mekanizmave specifike për të luftuar korrupsionin”*.¹⁷

¹⁷ Raporti i progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë, Tetor 2012, faqe 14, fq. 52

Për shkak të pasojave të rënda që sjell korrupsioni në deformimin e tregut dhe të konkurrencës, si dhe në frenimin e investimeve të huaja, lufta kundër tij kërkon kontributin e të gjitha institucioneve. Ka një hendek në mes të pritjeve të palëve të interesuara në vend dhe mandatit të auditimit për KLSH. Tradicionalisht, institucionet supreme të auditimit kanë rënë dakord që përgjegjësia primare për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit qëndron tek autoritetet administrative, të tilla si policia apo agjencitë antikorrupsion. SAI-t nuk e kanë parë mashtrimin dhe korrupsionin si qëllimin e tyre kryesor. Qasja ka qenë më tepër për të parandaluar korrupsionin, se sa në zbulimin e aktiviteteve të paligjshme. Nga ana tjetër publiku beson me shumë në rolin antikorrupsion të KLSH-së. *Institucioni do të vazhdojë ta respektojë këtë sensibilitet popullor dhe krahas veprimtarisë audituese dhe modernizimit të tij, do të vazhdojë të thellojë luftën kundër korrupsionit, duke denoncuar aktet korruptive në publik, media, Prokurori e më gjerë.*¹⁸ Institucioni do të respektojë këtë ndjesi dhe pritshmëri të publikut, si dhe do të mënjanojë pengesat, duke vijuar të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit dhe duke denoncuar aktet korruptive në publik, në media, në Prokurori etj.

Megjithatë, institucioni do ta vendosë më shumë theksin në analizën e rreziqeve dhe dobësive të sistemeve që auditon, duke synuar uljen e këtyre rreziqeve dhe parandalimin efektiv të korrupsionit, në bazë të standardit ISSAI 1240, i cili përcakton qartë rolin e SAI-t në luftën kundër korrupsionit.

KLSH do të vazhdojë të luaj një rol aktiv në forcimin e qeverisjes së mirë, zbatimit të standardeve të etikes, si edhe ngritjen e vetëdijes për rrezikun e mashtrimit dhe korrupsionit. Funkzioni kryesor i KLSH në këtë luftë është nxitja e një mjedisi parandalues kundër mashtrimit dhe korrupsionit, duke përfshirë forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe identifikimin dhe korrigjimin e mangësive.

KLSH gjykon se forcimi i kapaciteteve të auditimit është një strategji efektive për të mbështetur përmirësimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje. Qeverisja e mirë është një antidot i fortë ndaj korrupsionit dhe mashtrimit. Mashtrimi në sektorin publik dhe korrupsioni lulëzojnë, kur përgjegjshmëria dhe transparenca mungojnë. Raportimi i mirë financiar dhe auditimi ndihmojnë në reduktimin e veprimeve mashtruese.

Në Simpoziumin e Vjenës në shkurt 2009, një veprimtari e përbashkët OKB-INTOSAI për rolin e SAI-ve në luftën kundër korrupsionit, pjesëmarrësit theksuan në rezolutën përfundimtare “...rendësin e pavarësisë, të trajnimit të përshtatshëm dhe të raportimit publik të SAI-ve. SAI-t auditojnë të gjitha veprimet e qeverisë dhe kështu ata janë të pozicionuar në një mënyre unike për të luftuar korrupsionin”.

¹⁸ Vlerësimi i sigmas në vitin 2010, Menaxhimi i Shpenzimeve Publike dhe Kontrollit ", fq. 58.

Paralelisht, edhe lufta kundër korrupsionit dhe roli parandalues i KLSH-se do të jenë politika dhe veprime qendrore në vitet 2013-2017. Institucioni do të sinergjizojë veprimtarinë e tij me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara.

Ekspozimi ndaj mashtrimit dhe korrupsionit mund të zbutet nëse qeveria ka ngritur politika efikase antikorrupsion. Strategjia e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë kërkon një përgjegjësi të shtuar të të gjitha strukturave qeveritare që ajo koordinon dhe KLSH do të auditojë dhe vlerësojë realizimin e politikave të Strategjisë, duke dhënë rekomandime për zbatimin dhe përmirësimin e masave të parashikuara në të.

KLSH do të angazhohet për krijimin e Institutit të Përgjegjësisë Materiale për vendimmarrjet e zyrtareve publike, si një nder mekanizmat e rëndësishëm për të parandaluar shkeljet dhe abuzimin me pushtetin.

KLSH do të inkurajojë audituesit e brendshëm që të vendosin theksin në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Ky inkurajim do të kryhet edhe përmes shkëmbimit të informacionit dhe programeve të auditimit.

KLSH ka iniciuar në maj 2012 Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe kjo marrëveshje është në veprim dhe do të realizohet e plotë në vitet që vijojnë në objektivat e saj kryesore, që janë sinergjizimi i luftës kundër dukurive të mashtrimit financiar e korrupsionit, shmangia e dublimeve në auditim dhe reduktimi i kostove. Institucioni, nëpërmjet ndihmës së auditimit të brendshëm do të zhvillojë një qasje unike auditimi, duke përdorur rezultatet e punës së këtij të fundit, nëse ajo është në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Auditimi i brendshëm mund të marrë raportet e auditimit të jashtëm (KLSH) dhe të kontrollojë se si Menaxhimi i ndjek rekomandimet, si dhe mund të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

Objektivi Nr. 6 Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit

KLSH do të zbatojë një strategji të re komunikimi, duke theksuar marrëdhëniet e tij me publikun dhe Kuvendin, si dhe duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për vitet 2013-2017, KLSH:

- ☞ Do të shtojë gradualisht duke arritur në fund të periudhës që ta dyfishojë praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median vizive dhe të shkruar të vendit;

- ☞ Do të jete e pranishme me editoriale dhe shkrime te tjera në mediat kryesore të shkruara për problematikën e auditimit publik në vend;
- ☞ Do të rrisë bashkëpunimin dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e vrojtimeve dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike;
- ☞ Do të realizojë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe median publikime: fletëpalosje, buletine, broshura dhe libra për forcimin e qeverisjes, rritjen e luftës kundër korrupsionit dhe të transparencës së administrimit publik. Në veçanti, qasja e botimeve të realizuara gjatë vitit 2012 do të vijojë dhe do të thellohet më tej ;
- ☞ Do të realizojë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe median tryeza pune, dëgjime publike, konferenca dhe simpoziume për rritjen e transparencës dhe shkallës së përgjegjshmërisë së administratës publike në menaxhimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.
- ☞ Do të vijojë botimin e revistës shkencore katërmujore "Auditimi Publik", e cila u botua për herë të parë në vitin 2012
- ☞ Do të organizojë, duke filluar nga viti 2013, konferencën shkencore vjetore "Për auditimin e jashtëm publik në Shqipëri".
- ☞ I njëjti përafrim do të zbatohet për përgatitjen në shtyp ose raporte, të cilat kalojnë nëpërmjet medias, duke dhënë mesazhe të rëndësishme në një mënyrë të lehtë, të thjeshtë dhe të drejtpërdrejte. Institucion do të jetë i pranishëm në media me anë të artikujve të ndryshëm problematike, përgatitur nga menaxhimi apo auditues me përvojë, në mënyrë që të përcjellë një metodë të plotë dhe të qartë informuese për publikun.

Gjate vitit 2012, KLSH filloi të intensivikojë përpjekjet e tij të komunikimit. Kjo rezultoi në rritjen e vëmendjes së medias për raportet e auditimit dhe për institucionin në tërësi. Në prill 2012, KLSH finalizoi gjashtë marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-të më aktive në luftën kundër korrupsionit dhe transparencë në administratën publike, si: Transparency International në Shqipëri, Lëvizja Alternativa Civile, Qendra për Transparencë dhe Informim , Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Lëvizja Evropiane në Shqipëri. Gjithashtu, në dhjetor të vitit 2012 nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Institutin "G&G Group", i cili lufton korrupsionin dhe kërkon transparencë të shtuar në çështjet mjedisore.

Në zbatim të komunikimit pro-aktiv të KLSH, gjatë vitit 2012, institucioni ka përgatitur dhe botuar këta libra: "KLSH-analiza vjetore 2011", " KLSH në Kuvend", KLSH – Analiza e gjashtë mujorit të parë 2012", "EUROSAI dhe SAI-t evropiane ", "Standardet ndërkombëtare ISSAI" (1, 10, 11, 20, 30, 40, 100, dhe 200), "Historiku e KLSH" , tre edicionet e para të revistës shkencore "Auditimi Publik", si dhe përditësimi i "Manualit të Auditimit të Performancës ".

Për herë të parë, në Janar 2012, u organizua Analiza Vjetore e Performancës së KLSH, në nivel të përgjithshëm dhe në nivel departamenti, ku ishin të pranishme edhe mediat dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Ky aktivitet u përsërit edhe në vitin 2013.

Bashkëpunimet e KLSH me INTOSAI, EUROSAI dhe institucionet homologe evropiane, do të intensifikohen nëpërmjet vendosjes së kontakteve të vazhdueshme, aktiviteteve trajnuese në shtetet e zhvilluara evropiane, shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave, si dhe kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve institucionale. Ky bashkëpunim do të vazhdojë të zgjerohet edhe më tej në planin e brendshëm duke forcuar marrëdhëniet me institucionet e zbatimit të ligjit, auditimin e brendshëm dhe të gjitha grupet e tjera të interesit.

Burimet

Burimet në dispozicion të KLSH për realizimin e strategjisë janë burime të brendshme dhe të jashtme. Institucioni është i angazhuar për t'i përdorur këto burime me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Kapacitetet njerëzore të KLSH janë burimi ynë kryesor. Një pjesë e konsiderueshme e audituesve, veçanërisht përgjatë vitit 2012, kanë marrë trajnime afat-shkurtra pranë institucioneve homologe dhe do të marrin përgjegjësinë e realizimit të objektivave. Ata zotërojnë një nivel të mirë ekspertize dhe janë në gjendje ta ndaje atë me të gjithë stafin e angazhuar në KLSH. Ndërkohë që gjatë 6 muajve të parë 2013 ka përfunduar trajnimi afat-shkurtër jashtë shtetit i të gjithë punonjësve të KLSH.

Jemi të angazhuar dhe strategjia kërkon që të formulohen politika të përshtatshme për krijimin e një stafi kompetent, të aftë që të përballojë misionin dhe objektivat e strategjisë. Programet tona të trajnimit do të jenë të fokusuara për të siguruar që stafi ynë të pajiset me njohuritë e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij, në mënyrë që të prodhojë raporte të besueshme dhe t'i komunikojmë publikut dhe Kuvendit gjetjet e auditimit. Përfitimi i trajnimeve të vazhdueshme që ka filluar që gjatë vitit 2012 dhe do të vazhdojë edhe më tej si një normë e detyrueshme do të rrisë nivelin e ekspertizës së stafit.

Aktualisht, në KLSH punojnë 161 punonjës, nga të cilët 125 në sektorin e auditimit dhe 36 në shërbimet mbështetëse. Puna e KLSH është e mbështetur edhe nga katër ekspertë të jashtëm të fushave të ndryshme me përvojë në fushën e auditimit ose në qarqet akademike.

Ndryshimet strukturore që parashikohen të bëhen si dhe kërkesat për certifikimin e audituesve do të rrisin cilësisht burimet e brendshme të KLSH. Me urdhër të veçantë të Kryetarit, gjatë vitit 2012 stafi aktual është inkurajuar të vazhdojë karrierën profesionale dhe shkencore, të plotësojë CV-të në shumë plane, të përmirësojë dhe shtojë zotërimin e gjuhëve të huaja, çka po reflektohet pozitivisht nga një pjesë e konsiderueshme e stafit. Politikat e reja të rekrutimit që i japin

përparësi rekrutimit të personelit në moshë relativisht të re dhe që kanë kryer kualifikime shkencore është një burim tjetër potencial për realizimin e strategjisë. Politika të reja do të formulohen edhe në lidhje me zhvillimin e karrierës si dhe promovimin e shpërblimin financiar të punonjësve.

Buxheti i Shtetit i ka alokuar burime financiare modeste KLSH për të kryer veprimtarinë e auditimit. Megjithatë, fakti që këto burime përdoren në mënyrë të pavarur është një tjetër siguri për të përmbushur minimumin e përgjegjësive. Nevoja për shtesë të konsiderueshme të burimeve financiare për KLSH është imediate dhe përgjithësisht duhet theksuar se dashamirësia nga Kuvendi dhe Qeveria ekziston, por mundësitë e Qeverisë për plotësimin e nevojave të institucionit ende nuk janë të duhurat. KLSH i nevojitet me përparësi rinovimi tërësor i inventarit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, si dhe ambiente të reja për zyrat e tij, ku të sigurohet një standard minimal për logjistikën e audituesve.

KLSH do të bëjë përpjekje për të rialokuar burimet për të rritur produktivitetin, siç është përmendur në nën-objektive 2.1, mbi bazën e një analize të ngarkesës së punës që do të kryhet gjatë vitit 2014. Burime shtese priten t'i vijnë në ndihmë institucionit nga asistencë e huaj teknike. Një projekt i shkruar që përmban komponentët kryesorë të kësaj strategjie i është paraqitur delegacionit të BE në Shqipëri, në kuadër të programeve IPA 2013 dhe ka gjetur mbështetjen në shumën prej 2.1 milion euro. Ky projekt është menduar për të mbështetur zbatimin e Strategjisë dhe reformimin e zhvillimin e mëtejshëm të KLSH. Ai pritet të fillojë në vitin e dytë të zbatimit të kësaj Strategjie, në vitin 2014.

Burime cilësore suplementare në fushën e zhvillimit të burimeve njerëzore janë siguruar këtë vit dhe parashikohet të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme nga SIGMA, e cila ka zhvilluar me sukses disa misione për trajnimin e stafit të KLSH gjatë vitit 2012 dhe 6 muorit të parë 2013. Ndërkohë janë vendosur kontakte dhe priten të sigurohen burime të tjera financiare nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë lidhur me zhvillimin e trajnimeve afatshkurtra të stafit.

Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me disa nga SAI-t homologe gjatë vitit 2012 dhe 6 muorit të parë 2013 parashikojnë dhënien e mbështetjes për zhvillimin e burimeve njerëzore. Të tilla janë trajnimet e zhvilluara në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë (NIK), në Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, në Gjykatën e Llogarive të Turqisë dhe në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, ndërkohe që mbështetje të tjera parashikohen të sigurohen nga SAI të tjerë si ai i Austrisë, Kroacisë.

Të vështruara në tërësinë e tyre, këto burime vlerësohet se do të krijojnë mundësinë për të mbuluar dhe mbështetur plotësisht aktivitetet e KLSH-se në përmbushjen e misionit të tij, për informimin e publikut dhe Kuvendit lidhur me përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të subjekteve publike për përdorimin e parave publike me ekonomikitet, efektivitet dhe efizienz.

Monitorimi i Strategjisë, kontrolli dhe raportimi

Suksesi i strategjisë është i lidhur edhe me monitorimin e vazhdueshëm të progresit të objektivave dhe masave, si dhe korrigjimin në kohe apo përcaktimin e objektivave dhe masave të reja.

“Kryetari i SAI-t duhet të krijojë një mekanizëm monitorimi mirë-funksionues në mënyrë që të ndiqen rezultatet e implementimit të strategjisë, cilësisë së sistemit të kontrollit, komunikimit, burimeve njerëzore dhe kërkesave etike. Për vendosjen e ”tone at the top” (tonifikimit nga drejtimi)” të duhur, Kryetari i SAI-t duhet të ketë nën vëzhgim të gjithë sistemin dhe të shohë vetë rezultatet e marra”¹⁹.

Departamenti i Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe TI i KLSH përcaktohet si njësi përgjegjëse për ndjekjen dhe raportimin e progresit të kësaj strategjie. Strukturat përgjegjëse në institucion, të cilave u janë adresuar masa në Planin e Veprimit i paraqesin këtij Departamenti jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i gjashtëmujorit të çdo viti, një raport me shkrim lidhur me progresin e zbatimit të masave, si dhe një vlerësim për shkaqet e mosrealizimit të masave dhe propozimet eventuale për ndryshimin e masave, objektivave apo afateve, kurdoherë të arsyetuara. Ky departament, pas marrjes çdo gjashtë muaj të raporteve të zbatimit të Strategjisë nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara, kryen verifikime të mëtejshme dhe konsultime dhe mbi bazën e një analize të plotë të progresit të zbatimit, bën propozime për ndryshimin e objektivave, masave dhe afateve të zbatimit dhe jo më vonë se 30 dite nga mbarimi i gjashtëmujorit të çdo viti ja paraqet Kryetarit të KLSH, i cili vendos në lidhje me këto propozime.

Institucioni do të rishikojë tërësisht Strategjinë dhe objektivat e tij çdo dy vjet, pavarësisht nga procedurat e monitorimit çdo gjashtë muaj. I gjithë menaxhimi i lartë i institucionit do të angazhohet në rishikimin e saj dhe mendimet do të tërhiqen në nivel të çdo njësie auditimi. Raporti përfundimtar i rishikimit do të miratohet nga Kryetari i KLSH dhe do t'i shpërndahet të gjithë stafit të KLSH.

¹⁹ Prezantimi i Prof. Assoc. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë në Konferencën EUROSAI-OLACEFS në Tbilisi, Gjeorgji, tetor 2012, fq. 13